



ARGUMENTUM

news opinion analysis



SULM TERRORIST

Serbia tenton të aneksojë Veriun e Kosovës. NATO miraton forca shtesë për Kosovën

-Ekskluzive/ Ambasadori rus në Shqipëri z. Mikhail Afanasiev: Rusia synon vetëm të përfundojë atë luftë, të nisur nga Perëndimi në Ukrainë

-Shqipëria drejton Këshillin e Sigurimit në OKB

- Kosovo's Prime Minister Albin Kurti: Hard day for our country

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 JO VETEM LAJM- KOSOVË

- Sulmi terrorist/ Serbia tenton të aneksoje veriun e Kosovës. NATO miraton forca shtesë për Kosovën

08 POLITIKË

- Kryeministri Rama flet për Kosovën/ BE të dënojë shpalljen e zisë për terroristët. KFOR të marrë në kontroll veriun.

10 INTERVISTË/ EKSKLUZIVE

- Ambasadori rus në Shqipëri z. Mikhail Afanasiev: Rusia synon vetëm të përfundojë atë luftë, të nisur nga Perëndimi në Ukrainë.

16 FOKUS

- Shqipëria drejton Këshillin e Sigurimit në OKB/ Kryeministri Rama: Të mbështesim Ukrainën pa kushte!

19 REALPOLITIK

- “Organizata e Kombeve të Ndara”! Një paradigmë e re! ME dhe PER Prishtinën! “

ENGLISH EDITION

22 ENGLISH TOP NEWS

- Kosovo’s Prime Minister Albin Kurti: Hard day for our country.

- Assembly of Kosovo approves unanimously Resolution, condemning the Serb terrorist attack on the police.

- President Begaj pledges Albania’s dedication to Kosovo’s integrity and prosperity at UNGA 2023.

- PM Rama warns the attack in the north of Kosovo an alarm bell for the escalation of the crisis in an armed conflict.

26 IN FOCUS

- Census 2023 started in Albania on Monday which will last six weeks.

27 REALPOLITIK

- For a new paradigm by the EU and the USA for Kosovo and Serbia after the terrorist attack by serb bands on 24 september.

28 INTERVIEW

- Exclusive/ The Russian Ambassador to Albania Mr. Mikhail Afanasiev: Russia only aims to end that war started by the West in Ukraine.

30 BALKAN OVERVIEW

- Ministerial of Interior Ministers of the EU and WB countries held in Tirana in the framework of the Berlin Process.

31 GLOBAL

- G-20 leaders reach consensus, call for peace in Ukraine.



Serbia tenton të aneksoje veriun e Kosovës. NATO miraton forca shtesë për Kosovën

Me 24 shtator një grup i armatosur serb sulmoi policinë duke vrarë një oficer të policisë dhe plagosur një tjetër. Më pas grupi hyri me forcë në manastirin ortodoks në fshatin Banjskë duke vazhduar të qëllonjë mbi policinë. Përleshja përfundoi kur shumica e sulmuesve u arratisën. Tre nga sulmuesit e armatosur mbetën të

vrarë.

Ngjarjet e së dielës janë cilësuar si sulm terrorist nga institucionet e Kosovës dhe diplomatët perëndimorë, ndërsa Serbia mohon përfshirjen në sulm.

Rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, nga fshati Samadrexhë i komunës së Vushtrrisë, vdiq nga plagët e marra në sulm,

konfirmuan autoritetet.

Sipas tyre, njësitë policore vunë re në orët e para të së dielës vendosjen e dy kamionëve pa targa në urën në hyrje të fshatit Banjskë, të cilët kishin bllokuar lëvizjen.

Njësitë që shkuan në vendin e ngjarjes, u qëlluan me armë zjarri dhe njëri prej policëve u vra.

Autoritetet thanë se sulmuesit – rreth 30 syresh – ishin vendosur në manastirin e fshatit Banjskë të komunës së Zveçanit dhe përreth tij.

Ata shkëmbyen të shtëna me organet e rendit gjatë gjithë ditës së diel.

Në orët e mbrëmjes, ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se tre sulmues janë vrarë, ndërsa gjashtë persona, që dyshohet se ishin në kontakt me ta, janë arrestuar.

“I gjithë territori i vendit është vendosur nën kontroll”, tha Sveçla, por nuk tha nëse personat e tjerë të armatosur, janë larguar. Sipas tij, policia e Kosovës ka zbuluar edhe një sasi të madhe armatimi, përfshirë eksploziv, uniforma, logjistikë, ushqime e pajisje për barrikada.

“Lirisht mund të themi se ishin pajisje për disa qindra sulmues tjerë”, tha ministri i Brendshëm, për të shtuar se policia është duke kontrolluar edhe disa pelegrinë që kanë qenë në manastir, për të vërtetuar nëse ndonjëri prej sulmuesve është fshehur në mesin e tyre.

Prokuroria Speciale e Kosovës tha se gjashtë personat e arrestuar, të cilëve u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh, dyshohen për “vepra të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, “sulm kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës”, “përgatitje të veprave terroriste” dhe “armëmbajtje pa leje”.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti: Sulmi është mbështetur nga Serbia



Duke folur në një konferencë për gazetarë, Kurti i përshkroi sulmuesit e armatosur si “një njësi e organizuar profesionale, që ka ardhur për të luftuar në Kosovë”.

Ai i bëri thirrje grupit që t’iu dorëzohet autoriteteve kosovare.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se personat e armatosur ishin serbë lokalë të Kosovës, “të cilët nuk mund të vuanin më terrorin e Kurtit”. Vuçiq e dënoi vrasjen e policit të Kosovës, duke thënë se ajo “nuk mund të justifikohet”, por mohoi se Beogradi kishte ndonjë lidhje me sulmin.

I pyetur nga gazetarët se nga i siguruan serbët lokalë uniformat me të cilat shiheshin në fotografi, Vuçiq tha se ato “nuk janë uniforma të ushtrisë serbe apo të policisë serbe”. Uniformat blihen kudo në treg, tha ai.

“Fajtori i vetëm për atë që ndodhi në Kosovë është Albin Kurti”, tha Vuçiq, duke kritikuar edhe Perëndimin dhe, siç u shpreh, “hipokrizinë” e tij kur bëhet fjalë për Kosovën.

Sveçla: Serbia tentoi aneksimin e veriut të Kosovës, sulmuesit u trajnuan në baza serbe

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se vendi i tij ka mbledhur prova që dëshmojnë se Serbia u përpoq ta aneksojë veriun e Kosovës dhe se sulmuesit u përgatitën për një kohë të gjatë në bazat ushtarake të ushtrisë serbe brenda Serbisë.

Sveçla tha gjatë një konference për media të dielën në jug të Mitrovicës se mbi 90 persona morën pjesë në sulmin kundër Policisë së Kosovës.

“Serbia u mundua vazhdimisht të thotë se nuk ka të bëjë asgjë me këtë sulm, por faktet që do të publikohen dëshmojnë që përgatitjet, trajnimet dhe ushtrimet e këtij grupi u kryen në bazën e trajnimeve ushtarake afër Jagodinës si dhe në Kopaunik. Këto pamje u siguruan nga dronët e grupit terrorist të cilët i kemi konfiskuar”, tha Sveçla të dielën.

Ai tha se sulmuesit planifikonin ta hapnin “një kanal të gjatë nëntokësorë” nga Banjska deri në Serbi, për “furnizime nga shteti serb”.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, tha se grupi që e kreu sulmin në Banjskë ishte trajnuar për një kohë të gjatë në bazat ushtarake të ushtrisë serbe.

“Plani i [sulmuesve] ka qenë plan total i aneksimin të veriut të Kosovës. Në dokumentet që ne e kemi, të cilat nuk mund t’i ndajmë me ju tani, ka një plan për aneksimin të veriut të paraparë në fazën fillestare në 37 pozicione, nga ku do të sulmoheshin njësitet tona policore, jo vetëm në Banjskë e Zveçan por në të gjitha pjesët veriore, e pastaj krijimi i një korridorit të lirë për Serbi dhe furnizimet tjera me njerëz, materiale, ekspertë dhe furnizime të tjera të nevojshme për një rezistencë të armatosur dhe për krijimin e një realiteti të ri në vend”, tha Hoxha.

Përleshja e 24 shtatorit ishte kulmim i tensioneve që po zgjasin muajve të fundit në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Paralelisht me



bisedimet e ndërmjetësuara në Bruksel për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, situata në terren ka vazhduar të jetë e nxehtë dhe e tensionuar.

Vetëm në dhjetëditëshin e fundit, një varg ngjarjesh i paraprinë eskalimit në Kosovë.

Pak muaj më parë, tre policë të Kosovës u rrëmbyen nga forcat serbe. Në të njëjtën kohë, trupat e KFOR-it, gazetarët dhe policia e Kosovës u sulmuan nga bandat kriminale serbe. Sot, një polic i Kosovës ka mbetur i vrarë dhe dy të tjerë janë plagosur.

Këto veprime të frymëzuara nga Beogradi dëshmojnë se Serbia mbetet një kërcënim për stabilitetin rajonal, pavarësisht përpjekjeve të Perëndimit për ta afruar atë me BE-në, sidomos në kontekstin e mjedisit të sigurisë në Europë, si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.

Teksa mendimet dhe lutjet tona janë me familjarët dhe kolegët e Afrim Bunjakut që humbi jetën në krye të detyrës, si dhe për shërimin e shpejtë të policëve të lënduar, duhet mbështetur puna e policisë dhe institucioneve legjitime të Kosovës për të garantuar rregullin dhe sundimin e ligjit në përputhje me Kushtetutën.

Garantimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, vetëpërmbytja dhe bashkërendimi me partnerët ndërkombëtarë për të mos lejuar përshkallëzimin e situatës, mbeten çështje të një rëndësie parësore.

Kosova në ditë zie për oficerin e vrarë/ Afrim Bunjaku shpallet hero i Kosovës!

Krerët e institucioneve të Kosovës kanë nderuar në një mbledhje komemorative pjesëtarin e Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i vrarë më 24 shtator në përleshjet me një grup të armatosur në Banjskë të Zveçanit, në pjesën veriore të Kosovës.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka ndarë urdhrin “Hero i Kosovës” policit të vrarë nga terroristët serbë, Afrim Bunjaku.

Në mbledhjen komemorative që u organizua në nderim të policit Afrim Bunjaku, presidentja Osmani dha urdhërin e “Heroi i Kosovës” postmortem.

Nderimin e pranuan dy djemtë e policit të ndjerë.



Presidentja Osmani tha me këtë rast se rreshteri policor, Afrim Bunjaku ra në mbrojtje të rendit, ligjit, integritetit territorial dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës.

“Ai ra në mbrojtje të dinjitetit të Republikës sonë. Prandaj sot në emër të qytetarëve do t’i ndaj post-mortem urdhrin më të lartë të Republikës ‘Hero i Kosovës’. Shteti ynë nga sot ka edhe një hero, një kujtim më shumë për një njeri që me profesionalizëm dhe përkushtim iu dedikua mbrojtjes së Republikës për të cilën ra në krye të detyrës”, tha ajo në akademinë përkujtimore.

NATO miraton forca shtesë për Kosovën

NATO-ja tha se ka miratuar forca shtesë për Kosovën pas sulmit të 24 shtatorit mbi policinë



e Kosovës, por nuk dha më shumë hollësi për numrin e forcave.

Në një njoftim të NATO-s thuhet se Këshilli i Aleancës u takua sot(29.09) për të diskutuar situatën në Kosovë, duke shprehur shqetësimin e thellë për tensionet në rritje në veri të Kosovës. Në njoftim thuhet se KFOR-i ka një prani të dukshme në mbarë Kosovën dhe do të ndër-marr të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur një mjedis të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë.

“Që nga maji, ne kemi shtuar praninë e KFOR-it. Vetëm dje Këshilli i Atlantikut të Veriut autorizoi forca shtesë për të trajtuar situatën aktuale”, thuhet në njoftim, por nuk jepen më shumë hollësi për numrin e trupave.

“U bëjmë thirrje të gjitha palëve që urgjentisht të shtensionojnë situatën. Ne vazhdojmë t’i bëjmë thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të angazhohen në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian, si mënyra e vetme për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura dhe për të arritur zgjidhje që respektojnë të drejtat e të gjitha komuniteteve. Ky është çelësi për sigurinë

e qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitetin në rajon”, thuhet në njoftim.

Rreth 4 mijë e 500 trupa të udhëhequra nga NATO-ja janë të vendosur në Kosovë. Shtatëqind trupa shtesë u dërguan në Kosovë në fillim të qershorit pas trazirave të dhunshme të 29 majit kur mbi 90 pjesëtarë të këtij misioni mbetën të plagosur në përleshje me grupe protestuesish serbë që kundërshtonin zbatimin e rezultateve të zgjedhjeve lokale në veriun e Kosovës.

Milan Radoiçiç merr përsipër si organizator i vetëm i sulmit në Banjskë

Milan Radoiçiç, nënkryetar i deritashëm i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që mbështetet nga Beogradi, mori të premtën përgjegjësinë për përgatitjen dhe



udhëheqjen e grupit të armatosur që sulmoi policinë e Kosovës të dielën me 24 shtator, duke vrarë një oficer policie.

Në një deklaratë të lexuar nga avokati i tij Goran Petronijeviç, ai pretendoi se të gjitha përgatitjet i ka bërë “i vetëm” dhe pa mbështetjen e autoriteteve në Serbi.

“Po i njoftoj të gjithë përndjekësit e popullit serb nga (kryeministri i Kosovës Albin) Kurti e te ndihmësit e tij të shumtë të huaj, se unë personalisht i kam bërë të gjitha përgatitjet logjistike për mbrojtjen e popullit tonë kundër pushtuesit dhe ky akt i imi nuk ka asnjë karakter apo qëllim tjetër, dhe nuk ka të bëjë fare me të kaluarën time”, thuhet në deklaratë, në të cilën theksohet se për këtë Milan Radoiçiç nuk e ka njoftuar askënd prej strukturave qeveritare serbe apo atyre politike lokale në veri të Kosovës, dhe as nuk e ka pranuar “ndonjë ndihmë” prej tyre.

“Arsyeja e kthimit tonë ishte inkurajimi i serbëve, popullit të asaj zone, për t’i rezistuar terrorit të regjimit të Kurtit, duke mbrojtur njerëzit tanë, që çdo ditë i nënshtrohen atij terror”, thuhet në deklaratë.

Milan Radoiçiç tha se për aksionin e së dielës nuk e ka njoftuar askënd nga strukturat qeveritare të Serbisë, strukturat politike lokale nga veriu i Kosovës dhe se nuk ka marrë asnjë ndihmë prej tyre, pasi sipas tij “tashmë kemi pasur qëndrime të ndryshme lidhur me metodat e rezistencës ndaj terrorit të (Albin) Kurtit”.

“Vdekja e policit ndodhi aksidentalisht, pas së cilës filloi një përleshje e ashpër nga të dyja anët, ku mbetën të vrarë tre bashkëluftëtarët tanë, heronj, të cilët dhanë jetën për lirinë dhe ruajtjen e Kosovës”, tha ai duke nënvizuar se pjesëtarë e grupit nuk janë terroristë por “luftëtarë për lirinë e popullit serb”.

Në deklaratë ai thotë se po jep dorëheqje nga posti i tij në Listën Serbe dhe do t’i përgjigjet ftesës së autoriteteve të Serbisë për t’u marrë në pyetje.

KRYEMINISTRI EDI RAMA FLET PËR KOSOVËN

BE të dënojnë shpalljen e zisë për terroristët. KFOR të marrë në kontroll veriun



Kryeministri Edi Rama në një konferencë për shtyp mbi zhvillimet në veri të Kosovës, Rama tha se “çka ne kërkuam në komunikimin me miqtë në Bruksel dhe çfarë kërkojmë prapë sot, nuk është rezultat i një hetimi, që është i mirëseardhur pa dyshim, por është dënimi pa ekuivok i vrasjes së një efektivit të Policisë në veriun e Kosovës nga një grup kriminal”.

“Gjithashtu dhe dënimi i aktit absurd të nderimit kombëtar në Serbi të disa kriminelëve të veshur me uniforma ushtarake, jo shtetërore dhe të armatosur deri në dhëmbë, të cilët u shfaqën

në Banjskë për një demonstrim force të paligjshme, me gjuhën e armëve të rënda dhe u asgjësuan nga mbrojtësit e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës”, theksoi ai

Rama theksoi se derdhja e gjakut të një ‘shërbëtori’ të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht sjell edhe mos dobinë e një hetimi të thelluar, por ajo çka nevojitet në këto momente është dënimi me zë të lartë dhe me gjuhë të qartë, jo vetëm për Kosovën, familjen e dëshmorit Afrim Bunjakut apo për drejtësinë, por për të gjithë Rajonin. Rama tha se i gjithë Ballkani pret për një përgjigje

me të njëjtën optikë morale dhe demokratike që Bashkimi Evropian e karakterizon.

“Këtu jemi para derdhjes së gjakut të pafajshëm, nuk është kalimtar që u vra në rrugë nga një makinë me targa serbe, është gjaku i një efektivit të policisë së shtetit të Kosovës. Nuk vrau veten se pa ca civilë serbë të armatosur me çifte, u vra nga njerëz të veshur ushtarakisht dhe të armatosur rëndë, që për Beogradin zyrtar janë të denjë për ta ulur në gjysmë shtizë flamurin e Serbisë. Ky është një karshillëk, ilegal nga ana e grupit ilegal aq dhe jo institucional nga shteti serb. Nuk ka nevojë për hetim,

kërkon dënim me zë të lartë dhe me gjuhë të qartë.”- tha Rama.

Kreu i qeverisë rikthehu edhe njëherë në vëmendje planin franko-gjerman si dhe thirrjet e tij edhe më të hershme që veriu i Kosovës të merret në kontroll nga KFOR, para se të jetë shumë vonë. Rama tha se çdo neglizhim i sotëm, mund të sjellë dobinë e më shumë trupave, si dhe të një nyjeje të vështirë për t’u zgjidhur në ditët në vijim.

“KFOR duhet të marrë në kontroll veriun e Kosovës. Çdo justifikim sot që ‘s’kemi trupa’ mund të bëjnë nesër ndërhyrjen shumë më të madhe në trupa por edhe në vështirësi.”- vijoi Rama.

Rama u ndal edhe më gjerë në komunikimin e sotëm, për lajmin ekskluziv që kishte siguruar përmes burimeve, Shqip-tarja.com, ku për herë të parë Shqipëria nuk linjëzohej me deklaratat e BE-së për Kosovën.

Faktikisht, Rama u kujdes të theksonte së Shqipëria nuk ka asgjë konkrete me këtë deklaratë të BE-së, sepse është dhe vijon të jetë mbështetëse për një dialog të Kosovës dhe Serbisë, pasi është në interesin strategjik të vendit tonë. Kryeministri thotë se nisur nga zhvillimet dramatike në veri të Kosovës, do duhej një deklaratë e dytë, në mënyrë që Serbia të cilësohej si përgjegjëse për 12 orët luftë në Zveçan. Rama theksoi se ky qëndrim i Shqipërisë nuk u mirëprit mirë nga miqtë e Brukselit, por megjithatë, Shqipëria nuk tërhiqet.

Ai shtoi se Brukseli aktualisht nuk e kishte të mundur të realizonte një deklaratë të dytë, të cilën kryeministri e sheh si të domosdoshme për t’u dëgjuar nga Kosova e i gjithë Ballkani.

“Për herë të parë në 10 vitet e

Gjithashtu dhe dënimi i aktit absurd të nderimit kombëtar në Serbi të disa kriminelëve të veshur me uniforma ushtarake, jo shtetërore dhe të armatosur deri në dhëmbë, të cilët u shfaqën në Banjskë për një demonstrim force të paligjshme, me gjuhën e armëve të rënda dhe u asgjësuan nga mbrojtësit e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës”.

fundit, Shqipëria nuk u linjëzua me një deklaratë të politikës së jashtme të BE. Ky fakt ka shkaktuar një përshtjellim të kuptueshëm kur ja kemi përcjellë Brukselit.

Ne thamë se s’kemi ndonjë rezervë me deklaratën në vetvete, por njëkohësisht kemi theksuar domosdoshmërinë, sipas nesh, që ndikimi i kësaj deklaratë duhej të bëhej njëkohësisht apo të paktën të pasohej pa humbur kohë, nga një deklaratë e dytë mbi zhvillimet e pa tolerueshme në veri të Kosovës. Na u tha se nuk është e mundur momentalisht dhe se deklarata kritike ndaj Kosovës e kishte marrë aprovimin 3e vendeve anëtare dhe pritej të linjëzohej edhe Shqipëria. Përgjigja jonë ishte negative dhe nuk u pëlqye. Qëndrimi im nuk ndryshon, jemi gati të linjëzohemi sapo të dalë deklarata që ne pres-

im. Ky qëndrim ka të bëjë me çbalancimin total që deklarate e djeshme krijon në këto momente kaq dramatike, kur situata mund të përkeqësohet nga java në javë, dita ditë, apo në orë.”-tha Rama

Kryeministri Rama u shpreh se KFOR do duhet të marrë kontrollin në veri të Kosovës. Ai u shpreh se dy palët duhet t’i rikthehen dialogut sa është ende plani franko-gjerman në tryezë.

“KFOR duhet të marrë në kontroll veriun e Kosovës. E kam bërë shumë herë këtë propozim, e kam shpjeguar gjerë e gjatë pse. Çdo justifikim sot që ‘s’kemi trupa’ mund të bëjnë nesër ndërhyrjen shumë më të madhe në trupa por edhe në vështirësi.

Prandaj jam këtu sot dhe me vjen mirë që këtë e kërkon edhe Kosova, pra KFOR në veri. S’kam dëgjuar ta kundërshtojë Serbia. S’ka rëndësi fare këtu kush e kërkon, këtë e kërkon situata sot, po të ishte bërë më parë, s’do kishin ndodhur këto. Pak vonë sipas meje, po më mirë pak vonë sesa shumë vonë. Më vjen mirë që Osmani ka kërkuar publikisht ndihmën e SHBA- së për draftin e asociacionit. Në thelb kërkesa e saj është pozitive, është një hap më në fund në drejtimin e duhur nga ana e Kosovës. Nuk pa pikë rëndësi kush e shkruan kush e propozon, por ka rëndësi vetëm një gjë, drafti do përbushë kërkesën legjitime që ka procesi i dialogut, bazuar mbi një marrëveshje të nënshkruar mes qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Qeveritë shkojnë e vijnë shtetet serioze jo, vazhdojnë zbatojnë marrëveshjet. Plani franko-gjerman është ende në tryezë, historia mëson që nëse bën shumë naze se do më shumë, merr më pak.”- tha Rama.

Ambasadori rus në Shqipëri :

Rusia synon vetëm të përfundojë atë luftë, të nisur nga Perëndimi në Ukrainë

Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Federatës Ruse në Shqipëri SH.T.Z Mikhail Afanasiev

Intervistoi: MARJANA DODA

Tetëmbëdhjetë muaj pas Luftës në Ukrainë, ose siç e quan Rusia “operacioni special ushtarak”, flet për herë të parë që nga nisja e kësaj lufte, Ambasadori i Federatës Ruse në Shqipëri Z. Mikhail Afanasiev në një intervistë ekskluzive për **Argumentum.al**.

Kriza aktuale në Ukrainë nuk lindi në shkurt 2022, por nëntë vjet më parë, kur në Kiev, me mbështetjen aktive të SHBA-vë dhe BE-së, u krye një grusht shteti i armatosur dhe në pushtet erdhën forcat radikale nacionaliste, thekson që në krye të herës Ambasadori rus.

Ambasadori Afanasiev flet për një “hakmarrje” nga ana e Kievit kundër banorëve të Donbasit, kur banorët kërkuan respektimin e të drejtave të tyre legjitime, përfshirë të drejtën për të folur në gjuhën amtare.

“Kundër banorëve të Donbasit u vendos një bllokadë çnjerëzore sociale, ekonomike dhe e transportit, nisën bombardimet, goditjet e përditshme me raketa, si rezultat i të cilave humbën jetën 14 mijë civilë, midis tyre 130 fëmijë”, thotë Ai.

Lidhur me përpjekjet për të gjetur një zgjidhje diplomatike të këtij konflikti, Ambasadori kujton propozimet ruse të vitit 2021.

“Në mesin e dhjetorit 2021 Rusia përgatiti dhe u dërgoi partnerëve perëndimorë propozime për zhvillimin e garancive juridike për sigurinë në Evropë, të cilat preknin, ndër të tjera, edhe moszgjerimin e NATO-s në Lindje, refuz-



imin e çdo veprimtarie ushtarake në Ukrainë, kthimin e infrastrukturës së aleancës në konfigurimin e vitit 1997, kur u nënshkrua Akti Themelor Rusi-NATO. Megjithatë, këto propozime u injoruan me kryelartësi nga SHBA-të dhe NATO”, thekson Ambasadori Afanasiev.

Por ajo çfarë bëri që Rusia të ndërmernte vendimin e pakthyeshem kundrejt Ukrainës, sipas Ambasadorit rus ishin pretendimet e Kievit, të shprehura publikisht nga Zelensky në fillim të shkurtit 2022 në Konferencën e Mynihut për Sigurinë, lidhur me zotërimin e armëve bërthamore, gjë që krijonte rreziqe reale për Rusinë dhe sigurinë ndërkombëtare në tërësi.

Sa i përket sanksioneve perëndimore dhe izolimit të Rusisë, Ambasadori thotë:

“Shumica e komunitetit ndërkombëtarë, dmth vendet, në të cilat jeton më shumë se gjysma e gjithë njerëzimit të rruzullit tokësor, përfshirë aktorë të tillë të mëdhenj dhe me ndikim, si Afrika e Jugut, Algjeria, Etiopia, India, Irani, Kina, Pakistani, etj., refuzuan të vendosnin sanksione jolegjitime antiruse”.

Me tej ai thekson se në kushtet e botës shumëpolarëshe, e cila po formohet përkundër këtyre orvatjeve, zhvillimi i bashkëpunimit me shtetet e CIS, Azisë, Lindjes së Mesme, Afrikës dhe Amerikës Latine është prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Rusisë në fazën e sotme.

I pyetur për unifikimin perëndimor si bllok kundër Rusisë në këtë konflikt me Ukrainën, Ambasadori kthehet pas në histori duke rikujtuar luftërat e mëparshme

kundër Ruisë të cilat kanë rezultuar të pasuksesshme.

“Ashtu si Hitleri <...>, tani SHBA-të organizuan një koalicion me vendet e NATO-s dhe BE-së dhe, përmes Ukrainës, po zhvillojnë një luftë proxy kundër Ruisë. Nga historia e dimë se si përfunduan fushatat ushtarake të iniciatorëve keqdashës kundër vendit tonë”

Retorikën e përdorimit të armëve bërthamore, Ambasadori e quan një spekulim perëndimor, duke theksuar se Moska i përmbahet udhëzimeve doktrinale për çështjen e armëve bërthamore. “Përdorimi i tyre nga Rusia mund të vijë ekskluzivisht vetëm si përgjigje ndaj një agresioni të kryer me përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë ose atyre konvencionale. Pra, në rastet kur kërcënohet vetë ekzistenca e shtetit tonë”, thekson Z. Afanasiev.

Sa i përket qëndrimit të Tiranës zyrtare, krah Ukrainës, duket se Moska e mirëkupton pozicionin euroatlantik të Shqipërisë. “Ndonëse lidhjet politike dhe ekonomike midis dy vendeve aktualisht janë të kufizuara ndjeshëm, Moska është ende e hapur, veçanërisht në prag të mbushjes në vitin 2024 të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, për çdo kontakt konstruktiv me Tiranën zyrtare, kur dhe nëse ajo do të jetë e interesuar për të”, shprehet Ambasadori rus.

I pyetur për ofensivën ukrainase, ndërsa muajt e fundit kemi parë që disa drone kanë shenjëstruar Rusinë, ndonëse i dënon duke i quajtur veprime terroriste nga ana e Kievit, sërish Ambasadori Afanasiev thotë se pavarësisht ndihmës masive perëndimore, Rusia është e gatshme të zbrapsë çdo agresion.

E ndërsa flasim për një paqe të mundshme, nisur dhe nga disa iniciativa për paqe të ndërmarra nga shtete të ndryshme, Ambasadori duke vlerësuar ndërmjetësimin dhe nismat humanitare vendet e Jugut global thekson se Rusia ka



Ambasadori rus në Shqipëri, z. Mikhail Afanasiev

“Ndonëse lidhjet politike dhe ekonomike midis dy vendeve aktualisht janë të kufizuara ndjeshëm, Moska është ende e hapur, veçanërisht në prag të mbushjes në vitin 2024 të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, për çdo kontakt konstruktiv me Tiranën zyrtare, kur dhe nëse ajo do të jetë e interesuar për të”.



qenë dhe mbetet e hapur për një zgjidhje diplomatike të krizës. Në këtë intervistë, Ambasadori rus tregon gjithashtu se cilat janë elementët që do të sillnin paqen në Ukrainë.

INTERVISTA E PLOTË

Marjana Doda: I nderuar Ambasador, së pari ju falënderoj për këtë intervistë ekskluzive për Argumentum.al

-Në fakt kjo intervistë po zhvillohet pas 18 muajsh që nga dita kur Rusia filloi të ashtuquajturin “operacion special ushtarak” në Ukrainë. Çfarë e shtyu Moskën të ndërmarrë një hap të tillë?

SH.T.Z Mikhail Afanasiev: Para së gjithash, do të dëshiroja të vëreja se kriza aktuale në Ukrainë nuk lindi në shkurt 2022, por nëntë vjet më parë, kur në Kiev, me

mbështetjen aktive të SHBA-vë dhe BE-së, u krye një grusht shteti i armatosur dhe në pushtet erdhën forcat radikale nacionaliste. Kjo solli pasoja shkatërruese për vendin. Në fillim populli i Krimesë, i cili refuzoi të njohë diktatin e puçistëve, votoi për daljen e gadishullit nga përbërja e Ukrainës dhe bashkimin e tij me Rusinë, më pas shpërtheu konflikti në Donbas, ku banorët kërkuar respektimin e të drejtave të tyre legjitime, përfshirë të drejtën për të folur në gjuhën amtare, për të shkolluar fëmijët në këtë gjuhë, për të nderuar heronjtë e tyre, të cilët 80 vjet më parë shpëtuan botën nga fashizmi. Si përgjigje, Kievi akuzoi të gjithë banorët e jug-lindjes për “tradhëti shtetërore” e “terrorizëm” duke dërguar ushtrinë e rregullt dhe batalionet ndëshkuese neonaziste për të shtypur protestat. Kundër banorëve të Donbasit u vendos një bllokadë çnjerëzore sociale, ekonomike dhe e transportit, nisën bombardimet, goditjet e përditshme me raketa, si rezultat i të cilave humbën jetën 14 mijë civilë, midis tyre 130 fëmijë.

Një linjë të tillë destruktive të Kievit e mbështetën fillimisht SHBA-të dhe aletatët e tyre në NATO, të cilët inkurajuan rusofobinë agresive, mbyllën sytë ndaj shfaqjeve të neonazizmit, përvetësuan ushtarakisht territorin e Ukrainës, krijuan atje një rrjet laboratorësh biologjikë duke e shndërruar vendin në një placdarm ushtarak kundër Ruisë. Udhëheqja e Ukrainës dhe protezhetë e tyre perëndimore mashtruan qëllimisht komunitetin ndërkombëtar, duke shkelur në mënyrë cinike frymën dhe shkronjën e Marrëveshjeve të Minskut, të cilat përmbanin një plan realist për zgjidhjen e problemeve të Donbasit. Përveç kësaj, u zhvilluan përgatitje aktive për një ndërhyrje ushtarake në territorin e Republikave Popullore të Donetskut dhe të Luganskut me eliminimin e mëvonshëm të të ashtuquajturve “bashkëpunëtorë” si dhe të të gjithë mbështetësve të miqësisë

me Rusinë. Ishte e pamundur të injorohej më tej e gjithë kjo.

-A mendoni se u ezauruan të gjitha format diplomatike për të gjetur një zgjidhje paqësore në konfliktin Rusi-Ukrainë?

Siç e dini, në mesin e dhjetorit 2021 Rusia përgatiti dhe u dërgoi partnerëve perëndimorë propozime për zhvillimin e garancive juridike për sigurinë në Evropë, të cilat preknin, ndër të tjera, edhe moszgjerimin e NATO-s në Lindje, refuzimin e çdo veprimtarie ushtarake në Ukrainë, kthimin e infrastrukturës së aleancës në konfigurimin e vitit 1997, kur u nënshkrua Akti Themelor Rusi-NATO. Megjithatë, këto propozime u injoruan me kryelartësi nga SHBA-të dhe NATO. Një shqetësim serioz për Moskën ngjallën pretendimet e Kievit, të shprehura publikisht nga Zelensky në fillim të shkurtit 2022 në Konferencën e Mynihut për Sigurinë, lidhur me zotërimin e armëve bërthamore, gjë që krijonte rreziqe reale për Rusinë dhe sigurinë ndërkombëtare në tërësi. Si rezultat, nuk patëm zgjedhje tjetër, veçse të njihnim më 21 shkurt 2022 pavarësinë e Republikës Popullore të Donetskut dhe të Republikës Popullore të Luganskut, ndërsa më 24 shkurt të nisnim operacionin special ushtarak për mbrojtjen e Donbasit, demilitarizimin dhe denazifikimin e Ukrainës, si edhe eliminimin e kërcënimeve, që vinin nga territori i saj, ndaj sigurisë së Rosisë. Nënvizoj: gjatë operacionit special, Rusia synon vetëm të përfundojë atë luftë, tashmë të nisur nga Perëndimi në Ukrainë.

-Flitet shumë për izolimin ndërkombëtarë të Rosisë mbas 24 shkurtit. Në dy rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme të OKB- së 147 dhe 141 vende votuan pro duke dënuar shkeljen e sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Ukrainës. Shumica e tyre u janë bashkuar sanksioneve kundër Rosisë. Cili është

Një shqetësim serioz për Moskën ngjallën pretendimet e Kievit, të shprehura publikisht nga Zelensky në fillim të shkurtit 2022 në Konferencën e Mynihut për Sigurinë, lidhur me zotërimin e armëve bërthamore, gjë që krijonte rreziqe reale për Rusinë dhe sigurinë ndërkombëtare në tërësi.

komenti juaj, zoti Ambasador?

Do të dëshiroja të drejtoja vëmendjen Tuaj te fakti se, pavarësisht të gjitha dredhivë dhe presionit kolosal, përfshirë kërcënimet për sanksione, nëse vendet sovraane nuk do t'i bindeshin Uashingtonit, rezolutat antiruse nuk morën mbështetje të pakushtëzuar. Shumica e komunitetit ndërkombëtar, dmth vendet, në të cilat jeton më shumë se gjysma e gjithë njerëzimit të rruzullit tokësor, përfshirë aktorë të tillë të mëdhenj dhe me ndikim, si Afrika e Jugut, Algjeria, Etiopia, India, Irani, Kina, Pakistani, etj., refuzuan të votonin në mbështetje të rezolutave të sipërpërmendura dhe të vendosnin sanksione jolegjitime antiruse. Ndaj, kur flasim për "izolim" e Rosisë, Perëndimi edhe një herë pretendon me kryelartësi për rolin e burimit të vetëm të së vërtetës, për të cilin mendimi i vendeve të tjera nuk do të thotë asgjë. Pikërisht në këtë gjë edhe shfaqet politika e qënësishme neokolonialiste e SHBA-ve dhe aleatëve të tyre evropianë, të cilët synojnë me çdo çmim të ruajnë hegjemoninë botërore. Në kushtet e botës shumëpolarëshe, e cila po formohet përkundër këtyre orvatjeve, zhvillimi i bashkëpunimit me shtetet e CIS, Azisë, Lindjes së Mesme, Afrikës dhe Amerikës Latine është prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Rosisë në fazën e sotme. Ai po jep tashmë rezultate mbresëlënëse nga pikëpamja e rritjes së qarkullimit të mallrave, vëllimit të investimeve dhe kontakteve në fushat kulturore, humanitare e sportive. Shembulli i fundit, i qartë, është

samiti i zhvilluar pak kohë më parë i BRICS, gjatë të cilit rrethi i pjesëmarrësve të tij u dyfishua dhe përfshin tashmë, krahas anëtarëve fillestarë, shtete të tilla, si Arabia Saudite, Argjentina, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Etiopia dhe Irani.

- Nga ana tjetër ky konflikt ka forcuar dhe unifikuar aleancën midis vetë shteteve të perëndimit kundër Federatës Ruse. Sanksione ekonomike dhe politike për Rusinë. Ndërsa një mbështetje financiare, humanitare, diplomatike dhe ushtarake për Ukrainën. Aktualisht SHBA-ja ka miratuar që Holanda t'i dorëzojë Ukrainës avionë luftarakë F-16. A e priste Rusia këtë unifikim të Perëndimit kundër këtij konflikti?

Fakti që Perëndimi prej kohësh ka dashur t'i shkaktojë Rosisë një humbje strategjike nuk është diçka e re për ne. Ashtu si Napoleoni mobilizoi të gjithë Evropën kundër Perandorisë Ruse, ashtu si Hitleri pushtoi shumicën e vendeve evropiane dhe akumuloi resurset e tyre kundër Bashkimit Sovjetik, tani SHBA-të organizuan një koalicion me vendet e NATO-s dhe BE-së dhe, përmes Ukrainës, po zhvillojnë një luftë proxy kundër Rosisë. Nga historia e dimë se si përfunduan fushatat ushtarake të iniciatorëve keqdashës kundër vendit tonë.

-Retorika e armëve bërthamore është përdorur shpesh. Sa i madh është rreziku që ky konflikt të përshkallëzohet dhe të shkohet drejt një përplasjeje të armatosur midis fuqive bërthamore. A

po shkojmë drejt një lufte të tretë botërore?

Në të vërtetë, politikanët perëndimorë spekulojnë në mënyrë cinike me këtë temë, duke u përpjekur t'na atribuojnë qëllimin për të përdorur armë bërthamore në lidhje me atë që po ndodh në Ukrainë. Do të theksoj se Moska udhëhiqet në mënyrë rigorozë dhe të vazhdueshme nga parimi i papranueshmërisë së luftës bërthamore. Udhëzimet doktrinale ruse për çështjen e armëve bërthamore janë absolutisht mbrojtëse dhe lejojnë përdorimin e tyre nga Rusia ekskluzivisht si përgjigje ndaj një agresioni të kryer me përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë ose atyre konvencionale. Pra, në rastet kur kërcënohet vetë ekzistenca e shtetit tonë.

-Siç ju e dini, Shqipëria që në krye të herës është deklaruar krah Ukrainës, duke qene edhe bashkëpenëmbajtëse me SHBA në OKB. Sa ka ndikuar kjo në marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-Rusi?

Me keqardhje ne duhet të konstatojmë se lidhjet politike dhe ekonomike midis vendeve tona aktualisht janë të kufizuara ndjeshëm, dhe ky proces nuk filloi sot dhe jo për fajin tonë. Aktualisht, në politikën e tyre të jashtme, autoritetet shqiptare veprojnë vazhdimisht duke u nisur nga pozicionet e përbashkëta të NATO-s dhe Bashkimit Evropian në mbështetje të regjimit të Kievit, marrin pjesë në aktivitete të ndryshme proukrainase, përfshirë të ashtuquajturin samiti i "Platformës së Krimesë", promovojnë axhendën antiruse në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në të njëjtën kohë, Moska është ende e hapur, veçanërisht në prag të mbushjes në vitin 2024 të 100-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, për çdo kontakt konstruktiv me Tiranën zyrtare, kur dhe nëse ajo do të jetë e interesuar për të.

-Muajt e fundit kemi parë që tashmë dronet e Ukrainës po shënjestrojnë Moskën. A po troket kjo luftë në pragjet ruse?

Sulmet me dronë ukrainas të rajoneve ruse vetëm konfirmojnë natyrën terroriste të regjimit të Kievit. Ne shohim në veprime të tilla të Kievit dhe kuratorëve të tij të NATO-s një përpjekje frikacake për t'u hakmarrë ndaj civilëve për dështimin e të ashtuquajturit "kundërsulm", të cilin Forcat e Armatosura të Ukrainës e kanë zhvilluar pa sukses që nga fillimi i verës, si dhe një pamundësi për të ndryshuar situatën në linjën e kontaktit në favor të tyre, pavarësisht ndihmës masive perëndimore. Ju siguroj se Rusia është e gatshme të zbrapsë çdo agresion.

-Ndërsa konflikti në Ukrainë vazhdon, ka disa iniciativa për



Ambasadori rus në Shqipëri,
z. Mikhail Afanasiev

Do të theksoj se Moska udhëhiqet në mënyrë rigorozë dhe të vazhdueshme nga parimi i papranueshmërisë së luftës bërthamore.

Udhëzimet doktrinale ruse për çështjen e armëve bërthamore janë absolutisht mbrojtëse dhe lejojnë përdorimin e tyre nga Rusia ekskluzivisht si përgjigje ndaj një agresioni të kryer me përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë ose atyre konvencionale. Pra, në rastet kur kërcënohet vetë ekzistenca e shtetit tonë.

një paqe ose te paktën armëpushim të mundshëm midis Ruisë dhe Ukrainës. Këto u diskutuan ditët e fundit edhe në një takim të nivelit të lartë në Jedah, Arabi Saudite. Kina, Brazili, disa vende afrikane kanë draftet e tyre, të cilat janë diskutuar edhe në Moskë, Pekin dhe disa vende perëndimore. Cilat janë kushtet dhe kërkesat ruse për një paqe të tillë të mundshme?

Ne vlerësojmë shumë ndërmjetësimin dhe nismat humanitare të miqve tanë nga vendet e Jugut global që synojnë arritjen e paqes. Ndryshe nga regjimi i Kievit, i cili ndërpreu dhe më pas ndaloi plotësisht çdo negociatë me Rusinë, ne gjithmonë kemi qenë dhe mbetemi të hapur për një zgjidhje diplomatike të krizës dhe jemi të gatshëm t'u përgjigjemi propozimeve vërtet serioze. Sidoqoftë, duhet të konstatojmë se sot, për shkak të qëndrimit të udhëheqjes ukrainase dhe partnerëve të saj perëndimorë, të cilët janë gati të luftojnë "deri në ukrainasin e fundit", iniciativat ekzistuese nuk kanë asnjë shans për sukses.

Ne jemi të bindur se një zgjidhje gjithëpërfshirëse, e qëndrueshme dhe e drejtë është e mundur vetëm, nëse regjimi i Kievit do të përfundojë luftimet dhe sulmet terroriste, ndërsa sponsorët e tij perëndimorë – pompimin e forcave të armatosura të Ukrainës me armë. Për më tepër, duhet të konfirmohen themelet origjinale të sovranitetit të Ukrainës – statusi i saj neutral, jashtë blloqeve dhe jo-bërthamor. Duhet të njihen realitetet e reja territoriale të krijuara si rezultat i përdorimit nga banorët e rajoneve të reja ruse të së drejtës për vetëvendosje të sanksionuar në Kartën e OKB-së, duhet të sigurohen çmilitarizimi dhe denazifikimi i Ukrainës, të drejtat e qytetarëve të saj rusishtfolës dhe pakicave kombëtare. Zbatimi i këtyre elementeve përputhet plotësisht me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, për të cilat po lufton Rusia.

SHQIPËRIA DREJTON KËSHILLIN E SIGURIMIT NË OKB

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama: Të mbështesim Ukrainën pa kushte!



Udhëheqësit botërorë dhe ministrat e jashtëm që merrnin pjesë në debatin vjetor në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së u grumbulluan në dhomën e Këshillit të Sigurimit për takimin, i cili u fokusua në ruajtjen e Kartës së OKB-së përmes multilateralizmit efektiv në kontekstin e luftës në Ukrainë, që tani hyn në muajin e saj të 20-të.

Karta është dokumenti themelues i OKB-së dhe kodifikon parimet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke përfshirë barazimin e sovranë të shteteve dhe ndalimin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

“Ne duhet të pranojmë se OKB-ja e gjen veten në një ngërç për çështjet e agresionit. Njerëzimi nuk i mbështet më shpresat e tij të OKB-ja kur bëhet fjalë për

mbrojtjen e kufijve sovranë të kombeve,” tha zoti Zelenskyy në Këshill.

“Udhëheqësit botërorë po kërkojnë platforma dhe aleanca të reja që mund të zvogëlojnë shtrirjen katastrofike të problemeve – problemet që hasen këtu brenda këtyre mureve me retorikë, sesa zgjidhje reale; me aspirata për të bërë kompromis me vrasës, në vend të mbrojtjes së jetëve.”

Presidenca Shqiptare e Këshil-

lit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka drejtuar sesionin me temë “Respektimi i qëllimeve dhe i parimeve të Kartës së OKB-së nëpërmjet multilateralizmit: Ruajtja e paqes dhe sigurisë së Ukrainës”.

Debati i nivelit të lartë, i cili u drejtua nga Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të anëtarëve të KS-OKB-së, si dhe





zyrtarëve të tjerë, përfshirë edhe Presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy.

Takimi u drejtua nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, teksa vendi mban presidencën e rradhës të Këshillit këtë muaj.

Ambasadori rus Vasily Nebenzya: *Zoti President, u nxituat të thoni “pra, u vendos”. Kemi dy pyetje. Së pari e mbi të gjitha dua t’ju pyesim mbi ç’bazë propozoni që t’i jepnit presidentit të Ukrainës Volodymyr Zelenskyy fjalën përpara se të flasin anëtarët e Këshillit të Sigurimit, shumica e të cilëve përfaqësohen po kështu në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive. Pyetja e dytë që dua të bëj është mbi ç’bazë ftoni ju ministrin e jashtëm të Maqedonisë së Veriut në takimin e sotëm në cilësinë e kryetarit të OSBE-së?*

Kryeministri shqiptar Edi Rama: *“Dua të siguroj kolegët tanë rusë se të gjithë ata që janë këtu, se ky nuk është një operacion special i Presidencës Shqiptare, por një vijimësi e një praktike kohëgjatë e të konsoliduar të këtij Këshilli, për rrjedhojë është në përputhje të plotë*

me udhëzimet dhe praktikën e Këshillit”

Në përgjigje, ambasadori rus në OKB, replikoi se Shqipëria i kishte vendosur besimet e saj politike dhe ideologjike mbi detyrimet e këshillit.



Kryeministri i Shqipërisë,
Edi Rama

“Dua të siguroj kolegët tanë rusë se të gjithë ata që janë këtu, se ky nuk është një operacion special i Presidencës Shqiptare, por një vijimësi e një praktike kohëgjatë e të konsoliduar të këtij Këshilli, për rrjedhojë është në përputhje të plotë me udhëzimet dhe praktikën e Këshillit”.

Ambasadori rus Vasily Nebenzya: *“Ne nuk besojmë se argumentët që na paraqitët janë bindëse. Doja të na shpjegoni pse i është dhënë përparësi presidentit të Ukrainës. Nëse bëni këtë atëherë do përballeni me praktika shkelëse. Anëtarëve të KS kanë dëgjuar këto fjalë të Zelenskyt nëpërmjet video mesazheve. Këtu ka një shkelje flagrante sepse udhëtim i presidentit Zelensky për të ardhur këtu e për të folur, shihet si një privilegj në vend të të cilit gjatë seancës së fundit përfaqësuesi i Kievit vendosi të flasë përmes një video mesazhi.*

Zelensky gjatë vitit të kaluar u largua për shkak të rrethanave por kjo se ka ndaluar atë të udhëtojë drejt SHBA. Kjo shkelje ka rreziqe në KS sepse rrezikon të kthehet në një shfaqje. Kjo e sotmja do të jetë më shumë një spektakël. Ne nuk kundërshtojmë pjesëmarrjen e Zelenskyt por të bëhet sipas rregullave. Ata që nuk janë vende anëtare të flasin pas vendeve anëtare. Presidenca shqiptare ka treguar shkelje flagrante. Shqipëria ska mundur ta mbajë një gjë të tillë sot”

Më tej Ambasadori rus shtoi

se Shqipëria kishte shkelur gjithashtu rregullat, duke ftuar një numër të madh përkrahësish (të Ukrainës) nga vende te NATO, si edhe ministrin e jashtëm të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, si kreun e radhës së OSBE-së. Por Rama, në vijim të polemikës, i propozoi që t'i jepet fund luftës në Ukrainë, në mënyrë që edhe Zelensky të mos mbajë fjalën e tij.

Ambasarori rus Vasily Nebenzya: *Pjesëmarrja e zotit Osmani shërben për të çuar përpara rregullat e njëanshme të lojës. Ju bëjmë thirrje anëtarëve të Këshillit të Sigurimit që të mbajnë një qëndrim parimor në këtë drejtim dhe të flasin kundër këtyre qasjeve. Presidenca shqiptare ka treguar në fakt mospërfillje flagrante ndaj këtyre praktikave dhe ka vendosur bindjet ideologjike dhe të NATO-s mbi të gjitha mbi praktikën e Këshillit të Sigurimit i cili është një rojtar i qëndrimeve objektive. Për fat të keq Shqipëria nuk ka mundur ta menaxhojë një gjë të tillë sot”.*

Kryeministri shqiptar Edi Rama: *Më duhet të them se duke ardhur nga ju gjithë ky leksion i shkeljes së rregullave në këtë ndërtesë është një goditje mjaft mbresëlënëse, por duke qenë se e përsëritët shumë herë që shkelja këtu ka të bëjë me faktin që presidenti Zelenski do të flasë përpara anëtarëve të Këshillit, ka një zgjidhje për këtë. Nëse bini dakord. Ju ndaloni luftën dhe presidenti Zelenski nuk do të mbajë fjalën. Ajo çfarë e bëri të rëndësishëm atë për të gjithë ne ta dëgjojmë e mbase diskutojmë vjen nga diç-*



ka që e keni bërë ju, jo ne. Nga Presidenti Zelensky, kryeministri Rama mori një mesazh falenderimi për këtë gjest në platformën X, të njohur më parë si Twitter.

“I dashur Edi Rama, sot në



Ambasarori rus, Vasily Nebenzya

